VENDIM
Nr.1337, datë 10.10.2008

PËR KUOTAT E PRANIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE MASTER I NIVELIT TË PARË, ME KOHË TË PLOTË, SI DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT, TË MIRATUARA PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e miratuara për vitin akademik 2008-2009, në ciklin e dytë të studimeve, me kohë të plotë, të jetë 4 110. Këto kuota ndahen, si më poshtë vijon:

a) Për programet e studimit të ciklit të dytë (DND) 2 960;
b) Për programet e studimit master i nivelit të parë (MNP) 1 050;
c) Për programe të dyta studimi 100.

2. Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë (DND), me kohë të plotë, sipas shkronjës "a" të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahet sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyruar në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit master i nivelit të parë (MNP), me kohë të plotë, sipas shkronjës "b" të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahet sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyruar në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi, të përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të kërkesave të institucioneve publike të arsimit të lartë.

5. Institucionet publike të arsimit të lartë shpërndajnë kuotat e vëna në dispozicion të tyre, në masën jo më pak se 30 për qind, për studentët, që kanë përfunduar ciklin e parë në institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe jo më shumë se 70 për qind për ata që i kanë përfunduar këto studime pranë tyre. Në rastet kur nuk ka kandidatë, që plotësojnë kriteret dhe kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë, institucioni publik i arsimit të lartë ka të drejtë të plotësojë kuotën e vënë në dispozicion me studentët, që janë diplomuar në ciklin e parë, në atë institucion.

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve përcaktohen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë dhe ato bëhen publike.

6. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, të jenë, si më poshtë vijon:

a) Në Universitetin e Tiranës
I. Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:
i) Fizikë 40 000 lekë;
ii) Matematikë 40 000 lekë;
iii) të gjitha programet e tjera 56 000 lekë.
II. Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja 48 000 lekë;
III. Në Fakultetin Histori-Filologji:
i) Arkeologji 72 000 lekë;
ii) Trashëgimi kulturore 72 000 lekë;
iii) Të gjitha programet e tjera 48 000 lekë.
IV. Në Fakultetin e Shkencave Sociale 60 000 lekë.
b) Në Universitetin Politeknik të Tiranës:
I. Në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit 56 000 lekë;
II. Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike 48 000 lekë;

III. Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike 40 000 lekë;
IV. Në Fakultetin Gjeologji-Miniera 40 000 lekë;
V. Në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit 60 000 lekë.
c) Në Universitetin Bujqësor të Tiranës:
I. Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit 36 000 lekë;
II. Në Fakultetin e Bioteknolgjisë dhe Ushqimit 40 000 lekë;
III. Në Fakultetin e Shkencave Pyjore 36 000 lekë;
IV. Në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit 48 000 lekë.

7. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimit master i nivelit të parë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, të jenë:

a) Në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë, të jetë:
i) për lëndët fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre 24 000 lekë;
ii) të gjitha programet e tjera 32 000 lekë.
b) Në mësuesi, për arsimin e mesëm:
i) për lëndët fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre 32 000 lekë;
ii) të gjitha programet e tjera 36 000 lekë.

8. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si të verbër, të shurdhër, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuara, fëmijë romë apo fëmijë të policëve të rënë ose të plagosur, për shkak të detyrës, ish-të përndjekur politikë, që do të fitojnë të drejtën në një program studimi, të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, do të paguajnë një kuotë, në masën 50 për qind të tarifës së shkollimit.

Këtë të drejtë do ta kenë edhe studentët e viteve më të larta, që u përkasin po këtyre shtresave sociale.

9. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studentët përsëritës i nënshtrohen tarifës së shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdojnë studimet.

10. Në çdo program studimi, në ciklin e dytë të studimeve, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, studentët e shkëlqyer nga cikli i parë dhe cikli i dytë nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

Në programet e studimit master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, për lëndët fizikë, matematikë apo kombinimet e tyre, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, studentët me mesatare, të ciklit të parë, jo më të ulët se nota 8 (tetë), nuk paguajnë tarifën e shkollimit.

11. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të kërkesave të institucioneve publike të arsimit të larë.

12. Kuotat e pranimeve në ciklin e dytë të studimeve, sipas pikës 1 të këtij vendimi, që mbeten të parealizuara, rishpërndahen, sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1

Nr.	Emërtimet e programeve të studimit	UT	UPT	UBT	USH	Σ
1	Biologji mjedisore	30				30
2	Biologji molekulare	30				30
3	Fizikë	30				30
4	Bioteknologji molekulare dhe industriale	40				40
5	Kimia industriale dhe mjedisore	30				30
6	Inxhinieria e proceseve kimike	30				30
7	Shkencat dhe teknologjitë ushqimore	30				30
8	Kimi-analiza kimike dhe vetitë e lëndës	30				30
9	Matematikë	30				30
10	Inxhinieri matematike dhe informatikë	30				30
11	Informatikë	40				40
12	Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor e turistik	100				100
13	Përkthim teknik-letar dhe interpretim	80				80
14	Gjuhësi	100				100
15	Histori	100				100
16	Arkeologji	20				20
17	Trashëgimi kulturore	20				20
18	Marrëdhënie ndërkombëtare	30				30
19	Gazetari	150				150
20	Përkatësi gjinore dhe zhvillim	120				120
21	Psikolog shkollor/organizacional	30				30
22	Psikolog klinik i zhvillimit dhe marrëdhënieve	30				30
23	Filozofi sociale	100				100
24	Shkenca politike-teori politike	60				60
25	Sociologji e zhvillimeve shoqërore	40				40
26	Punë sociale	100				100
27	Inxhinieri elektronike		30			30
28	Inxhinieri e telekomunikacionit		30			30
29	Inxhinieri informatike		30			30
30	Inxhinieri elektrike		50			50
31	Inxhinieri mekanike		100			100
32	Inxhinieri materiale		50			50
33	Inxhinieri tekstili dhe mode		30			30
34	Inxhinieri gjeologjike		80			80
35	Inxhinieri e burimeve natyrore		80			80
36	Inxhinieri gjeofizikë		20			20
37	Inxhinieri gjeomjedis		20			20
38	Inxhinieri ndërtimi		150			150
39	Inxhinieri hidroteknikë		30			30
40	Inxhinieri gjeodezi		30			30
41	Inxhinieri agrare			150		150
42	Inxhinieri agromjedisi			50		50
43	Inxhinieri agroushqimore			60		60
44	Inxhinieri përpunim druri			20		20
45	Inxhinieri pyjore			20		20
46	Ekonomi dhe politika agrare			150		150
47	Financë-Kontabilitet			200		200
48	Menaxhim agrobiznesi			150		150
	Gjithsej	**1430**	**730**	**800**	**0**	**2960**

Tabela nr.2

Nr.	Emërtimet e programeve të studimit	UE	USH	UV	UK	UGJ	Σ
1	MNP në mësuesi në CLAB në gjuhë-letërsi	60	60		60	60	240
2	MNP në mësuesi në CLAB në biologji-kimi	80	80				160
3	MNP në mësuesi në CLAB në gjuhë italiane	30	30				60
4	MNP në mësuesi në CLAB në gjuhë gjermane	30	30				60
5	MNP në mësuesi në CLAB në gjuhë frënge	30	30				60
6	MNP në mësuesi në CLAB në gjuhë angleze	60	60		50		170
7	MNP në mësuesi në CLAB në matematikë-fizikë	30	30	30	30		120
8	MNP në mësuesi në CLAB në matematikë-informatikë	30	30				60
9	MNP në mësuesi në CLAB në histori-gjeografi	60				60	120
	Gjithsej	**410**	**350**	**30**	**140**	**120**	**1050**

ANEKS
ANALIZA E KOSTOS MESATARE PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË

NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në 000 lekë

Nr.i studentëve	20
Leksionet: 475 x 1.5 = 717 Seminare: 128 x 1 = 128 Laboratorë: 235 x 0.8 = 188 Praktikë: 125 x 0.5= 62.5 Prova finale: 350 Shuma e orëve të konvertuara: 1445.5	
Pedagogë	6.5
Pagat: 6.5 x 100 x 12.6 = 8190 Sigurime shëndetësore: 8190 x 21.7% = 1777.2 Shërbime: 8190 x 20% = 1638 Investime: 8190 x 20% = 1638	
Kostoja e të gjithë programit të studimit	13243.2
Kostoja e vitit të parë	6621.6

NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Në 000 lekë

Nr.i studentëve	40
Leksionet: 600 x 1.5 = 900 Seminare: 364.5 x 1 = 364.5 Laboratorë: 70 x 0.8 = 568 Praktikë: 40 x 0.5 = 20 Shuma e orëve të konvertuara: 1340	
Pedagogë	6.09
Pagat: 6.09 x 100 x 12.6 = 7673.4 Sigurime shëndetësore: 7673.4 x 21.7% = 1665.1 Shërbime: 7673.4 x 20% = 1534.6 Investime: 7673.4 x 20% = 1534.6	
Kostoja e të gjithë programit të studimit	12407.7
Kostoja e vitit të parë	6203.8

NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS

Në 000 lekë

Nr.i studentëve	60
Leksionet: 900 x 1.5 = 1350 Seminare: 600 x 1 = 600 Shuma e orëve të konvertuara: 1950	
Pedagogë	8.8
Pagat: 8.8 x 100 x 12.6 = 11088 Sigurime shëndetësore: 11088 x 21.7% = 2406 Shërbime: 11088 x 20% = 2217.6 Investime: 11088 x 20% = 2217.6	
Kostoja e të gjithë programit të studimit	17929.2
Kostoja e vitit të parë	8964.6

PROGRAM STUDIMI MASTER I NIVELIT TË PARË (MNP) NË MËSUESI

Në 000 lekë

Nr.i studentëve	60
Leksionet: 285 x 1.5 = 427.5 Seminare: 400 x 1 = 400 Praktikë: 100 x 0.5 = 50 Shuma e orëve të konvertuara: 977.5	
Pedagogë	4.44
Pagat: 4.44 x 100 x 12.6 = 5594.4 Sigurime shëndetësore: 5594.4 x 21.7% = 1213.9 Shërbime: 5594.4 x 20% = 1118.8 Investime: 5594.4 x 20% = 1118.8	
Kostoja e të gjithë programit të studimit	9045.9